Manuali Operacional Digical
Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale

Shpërndarja:	PUBLIK
Kodi i dokumentit:	ISP - SCD - 04 - 2022 - 06
	Kompania Sherbimi Kodi Viti Versioni

VERSIONET E MANUALIT OPERACIONAL TË NËNSHKRIMIT DIXHITAL NË DISTANCË

Versioni	Data e publikimit	Përshkrimi i ndryshimit
01	01/12/2018	Versioni i parë
02	02/07/2019	Rishikimi vjetor
03	31/10/2019	Rishikimi
04	30/11/2019	Përditësimi i dokumentit pas zëvendësimit të Vendimit 45 AgID
05	31/05/2020	Përditësimi i dokumentit pas krijimit të CA për Vazhdimësinë e Biznesit
06	30/06/2022	Përditësimi pas Inspektimit te AgID

PERMBAJTJA

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1.1 Vështrim i përgjithshëm

"Manuali Operacional i Nënshkrimit Dixhital në Distancë" (siç përcaktohet më poshtë) ka si qëllim rregullimin e certifikatave të kualifikuara për shërbimet e nënshkrimit elektronik të ofruara - në përputhje me Dekretin Legjislativ 82/2005 (Kodi i Administrimit Dixhital), i ndryshuar në vijim, dhe legjislacionin dhe rregulloret kombëtare dhe europiane në fuqi dhe të zbatueshme - nga Intesa Sanpaolo SpA për Përdoruesin (siç përcaktohet më poshtë) të Bankës Ndërkombëtare Filiale (siç përcaktohet më poshtë) në lidhje me shërbimet e kanaleve alternative - multichannel (pra aksesi nga Përdoruesi në shërbimet e ofruara nga Bankat Ndërkombëtare Filialeve përmes kanaleve dhe degës në distancë).
Manuali Operacional i Nënshkrimit Dixhital në Distancë i referohet gjithashtu rregullave teknike për zbatimin e kuadrit ligjor për nënshkrimin dixhital që parashikohet në DPCM, datë 22/02/2013. Nëse ndodh ndonjë ndryshim i ligjit, ky manual operacional do të modifikohet rregullisht për këtë qëllim.

1.2 Përkufizimet dhe interpretimet

Termat në vijim që përdoren në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- **"Aplikant**": personi që kërkon lëshimin e një certifikate të kualifikuar për nënshkrimin elektronik; për individët, aplikanti është i njëjti me Titullarin; për personat juridik, Aplikanti është gjithmonë një përfaqësues ligjor i personit juridik (mund të ketë më shumë se një Përfaqësues Ligjor për Personin Juridik);
- "**Degë**": vendi ku zhvillohet aktiviteti i biznesit midis klientit dhe Bankës, kjo përfshin të gjitha ambientet, zyrat dhe vendndodhjet e Bankës Ndërkombëtare Filiale.
- "**Autoriteti i Certifikimit**": ofruesi i shërbimit të besimit, i cili është i autorizuar të lëshojë certifikata të kualifikuar për nënshkrimin elektronik përmes një procedure certifikimi që është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjet dhe rregulloret europiane dhe kombëtare. Për qëllimet e këtij manuali operacional RDS, Autoriteti i Certifikimit është Intesa Sanpaolo S.p.A
- **"Person juridik":** jo-konsumator, pra një kompani publike ose private ose një person fizik që vepron brenda biznesit të tij / saj ose si një profesionist i vetëpunësuar, i cili nënshkruan Marrëveshjen e Përdorimit të Shërbimit të Bankës Dixhitale me një Bankë Ndërkombëtare Filiale dhe autorizon një Aplikant / Titullar që të përdor certifikatën e kualifikuar për nënshkrimin elektronik të lëshuar në emër të tij;
- **"Përdorues**": Përdoruesi i fundit individ ose person juridik, nënshkrues i Marrëveshjes për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit që lidhet me Bankat Ndërkombëtare Filiale.
- **"Blerje dixhitale"**: një kanal për të kryer një procesin e blerjes dixhitale përmes identifikimit me video që kryhet nga operatori bankë dhe dokumentit të identifikimit që paraqet Klienti;
- **"Bankat Ndërkombëtare Filiale"**: çdo Bankë Ndërkombëtare Filiale që i përket Grupit Intesa Sanpaolo;
- **"Titullari**": Përdoruesi në emër të të cilit është lëshuar një certifikatë e kualifikuar për nënshkrim elektronik; titullari është i autorizuar të përdorë një certifikatë të tillë për të nënshkruar në mënyrë dixhitale dokumente elektronike, duke siguruar autenticitetin e origjinës së dokumenteve elektronike dhe integritetin e përmbajtjes së tij, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në Marrëveshjen për Ofrimin e Shërbimeve të Certifikimit të Bankave Ndërkombëtare Filiale;
- **"Intesa Sanpaolo"**: Intesa Sanpaolo S.p.A., ofruesi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik
- **"Fjalëkalimi me një përdorim (OTP)":** fjalëkalim i vlefshëm vetëm për një transaksion dhe i cili gjenerohet dhe vihet në dispozicion Titullarit menjëherë përpara operacionit të nënshkrimit dixhital. OTP i dërgohet me sms klientit nëse kanalet janë "blerja dixhitale" ose degë. OTP gjenerohet nga TOKEN për shërbime bankare dixhitale në distancë.

- **"Autoriteti i Regjistrimit**": subjekti i caktuar kryesisht që (i) të identifikojë Aplikantët dhe të lidhë kontratën me Aplikantët, duke garantuar saktësinë e identitetit të tyre, (ii) t'i sigurojë Aplikantëve të gjithë informacionin mbi certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik dhe kufizimet e përdorimit të tyre, (iii) te lidh kontratën me Aplikantët në emër dhe për llogari të Intesa Sanpaolo dhe (iv) t'i dorëzojë Intesa Sanpaolo kërkesat për revokim dhe pezullim të certifikatave. Për qëllimet e këtij manuali operacional RDS, Autoriteti i Regjistrimit është ndonjë prej Bankave Ndërkombëtare Filiale të Intesa Sanpaolo S.p.A që ka nënshkruar me Intesa Sanpaolo S.p.A. një marrëveshje për certifikata të kualifikuar për nënshkrimin elektronik;
- **"Manuali operacional i nënshkrimit Dixhital në Distancë (RDS)"**: ky dokument, i ndryshuar dhe plotësuar në vijim.
- **"Banka"**: çdo Bankë Ndërkombëtare Filiale që i përket Grupit Intesa Sanpaolo
- **"TOKEN"**: Sistemet e sigurta të vërtetimit dhe autentifikimit sigurojnë certifikimin dhe autentifikimin strikt të klientit (SCA); përdoret për të gjeneruar fjalëkalimin me një përdorim (OTP) pas verifikimit të kodi PIN
- **"Kodi Privat":** është elementi i rezervuar i një palë kodeve asimetrikë të cilat ruhen në mënyrë të mbrojtur nga Ofruesi i Shërbimeve të Certifikimit në një pajisje të përshtatshme nënshkrimi
- **"Kodi Publik":** është elementi i një palë kodeve asimetrikë me të cilët kryhet vërtetimi dhe autentifikmi i nënshkrimit elektronik.

1.2.1 Referenca për dispozitat ligjore

[Dekreti legjislativ 82/2005]	Dekreti Legjislativ Nr. 82, datë 7 Mars 2005, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 16 maj 2005, - Shtojca e zakonshme nr. 93 "Kodi i Administrimit Dixhital", i përditësuar me Dekretin Legjislativ nr. 217, datë 13 Dhjetor 2017, publikuar në Fletoren Zyrtare nr.9, Janar 2018.
[DPCM]	Dekreti i Kryeministrit, datë 22 shkurt 2013 - Rregullorja teknike për krijimin, aplikimin dhe verifikimin e nënshkrimeve elektronike të avancuara, të kualifikuara dhe dixhitale, në përputhje me nenin 20 (3), 24 (4), 28 (3), 32 (3) germa b), 35 (2), 36 (2) dhe 71.
[CNIPA/CR/48]	CNIPA / CR / 48 Qarkorja nr. 48, datë 6 Shtator 2005 (publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 213, datë 13 Shtator 2005), Procedura për paraqitjen e aplikimit për t'u regjistruar në listën publike të ofruesve të shërbimeve të certifikimit, në përputhje me nenin 28 (1) të Dekretit Presidencial nr. 445, datë 28 dhjetor 2000.
Rregullorja BE 910/2014 – eIDAS	Rregullorja (BE) N. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 korrikut 2014 mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e mirëbesimit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93 / KE.
Rregullorja BE (BE) N°679/2016 – GDPR	Rregullorja (BE) Nr. 679/2016 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian , datë 27 Prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46 / KE (Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave).
Vendimi i AgID nr.121/2019	Udhëzime që përmbajnë Rregullat Teknike dhe Rekomandimet në lidhje me gjenerimin e certifikatave elektronike të kualifikuar, nënshkrimet dhe vulat elektronike të kualifikuara dhe vlefshmërinë e kualifikuar elektronike të kohës

1.3 Referencat për standardet

[LDAP2] Zeilenga, " Protokolli i aksesit në Direktorin Lightweight, version 2", Internet RFC 3494, Mars 2003.

[PKCS7] B. Kaliski, “PKCS#7: Sintaksa e mesazhit kriptografik Versioni 1.5”, Internet RFC 2315, Mars 1998.

[PKCS10] B. Kaliski, "PKCS#10: Sintaksa e Kërkesës së Certifikimit - Versioni 1.7", Internet RFC 2986, Nëntor 2000.

[SHA1] ISO/IEC 10118-3:2018, " Teknologjia e informacionit - Teknika të sigurisë - funksionet Hash - Pjesa 3: Funksionet e përkushtuara Hash", 2018.

[SHA-256] ISO/IEC 10118-3:2018, " Teknologjia e informacionit - Teknika të sigurisë - funksionet Hash - Pjesa 3: Funksionet e përkushtuara Hash".

[X500] ISO/IEC 9594-1:2008, ISO/IEC 9594-2:2008 “Teknologjia e informacionit - Ndërlidhja e sistemeve të hapura - Direktoria: Përmbledhje e koncepteve, modeleve dhe shërbimeve”.

[X509] ISO/IEC 9594-8:2008 “Teknologjia e informacionit - Ndërlidhja e sistemeve të hapura - Direktoria: Kuadrat e certifikatave të kodeve publik dhe dhënies së certifikatave”.

[RFC3647] Internet X.509 Politika e certifikatave të Infrastrukturës kryesore Publike dhe Kuadri i Praktikave të certifikimit të S. Chokhani, W. Ford, R. Sabett, C. Merrill, S. Wu.

[RFC 3778] Aplikacioni PDF Taft, Pravetz, Zilles, Masinter, Maj 2004.

1.4 Shkurtimet

Shprehjet e mëposhtme që përdoren në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë do të kenë shkurtimet e mëposhtme:

AgID Agjencia për Italinë Dixhitale,

CRL Lista e Revokimit të Certifikatave

CPS Deklarata e Praktikës së Certifikatës

DBMS Sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave

DN Emër i dalluar/njohur

DNS Sistemi i Emrave të Domenit

DPR Dekret Presidencial

HSM Moduli i Sigurisë së Harduerit

HTTP Protokolli i Transferimit HyperText

ITSEC Kriteret e vlerësimit të sigurisë së teknologjisë së informacionit

LDAP Protokolli i aksesit në Direktorinë Lightweight

NEI Instituti Kombëtar elektroteknik "Galileo Ferraris" (në italisht "Istituto Elettrotecnico Nazionale")

OTP Fjalëkalimi me një përdorim

PDF	Formati i Dokumentit Portabël
PIN	Numri Personal i Identifikimit
PKCS	Standardi Kryesor i Kriptografisë Publike
RDS	Nënshkrimi dixhital në distancë
RFC	Kërkesë për komente
RSA	Rivest-Shamir-Adleman
SHA-1	Funksioni i Sigurisë Hash 1
SHA-2	Funksioni i Sigurisë Hash 2
SSL	Secure Sockets Layer - Shtresa e sigurisë
URL	Lokalizuesi Uniform i Burimit

2. HYRJE

Nënshkrimi dixhital bazohet në kodet asimetrikë, një publik dhe një privat, të cilat sigurojnë vërtetësinë dhe autenticitetin e origjinës së dokumenteve elektronike të nënshkruara në mënyrë dixhitale dhe integritetin e përmbajtjes së tyre ndaj një ose më shumë marrësve që, nga ana tjetër, mund të verifikojnë vlefshmërinë përkatëse.

Dispozitat e reja të parashikuara në nenin 8 të [DPCM] lejojnë që Autoriteti Certifikues të ruajë kodet privatë të Mbajtësve (pra kodet që përdoren për të krijuar një nënshkrim dixhital) në pajisjet speciale të sigurisë (pra HSM), duke siguruar që përdorimi i kodeve do t'i jepet ekskluzivisht mbajtësit/titullarit, sikundër parashikohet në nenin 11 (2) [DPCM].

Rrjedhimisht, përdorimi i nënshkrimit dixhital nuk është më subjekt i zotërimit të setit të nënshkrimit dixhital nga titullari/mbajtësi (p.sh. karta inteligjente, lexues special dhe softueri përkatës), dhe autoritetet e certifikimit dhe regjistrimit mund të ofrojnë shërbime të nënshkrimit dixhital përdoruesve përmes kanaleve direkte (pra internetit, ueb, celularit).

Mbajtësi/titullari do të fillojë procesin e nënshkrimit dixhital përmes përdorimit të një fjalëkalimi me një përdorim - OTP (ose marrjes së një numri të certifikuar në celular ose, në Shërbimin Bankar në Distancë, të gjeneruar nga çelësi i sigurisë TOKEN duke vendosur kodin PIN), ndërkohë garantohet kontrolli i vetëm i Mbajtësit/Titullarit. Fillimi i procesit, nëse kryhet në Degë, mund të ndodhë gjithashtu përmes lexuesit të kartave (pra Mbajtësi/Titullari do të jetë në gjendje të kryejë hapin e parë duke skanuar kartën e tij të debitit pranë lexuesit të kartave në Degë).

Në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë shpjegohen proceset e mëposhtme:

- Procedurat e gjenerimit dhe menaxhimit të kodeve të nënshkrimit në shërbimin e Nënshkrimit Dixhital të Distancë të ofruar nga Intesa Sanpaolo;

- Procedura e aktivizimit të nënshkrimit dixhital në distancë dhe mekanizmi i rreptë i autentifikimit brenda bankës dixhitale në bazë të procedurës së autentifikimit dhe vërtetimit të përcaktuar nga Bankat Ndërkombëtare Filiale;

- Roli i Autoritetit të Certifikimit dhe Autoritetit të Regjistrimit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Manuali Operacional i Nënshkrimit Dixhital në Distancë i referohet të gjitha Bankave Ndërkombëtare Intesa Sanpaolo që janë pjesë e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale.

Paragrafët e mëposhtëm i referohen kërkesave që burojnë nga neni 40 (3) a, b dhe c të [DPCM].

2.1 Detajet e identifikimit të Autoritetit të Certifikimit

Shërbimi i certifikimit ofruar nga subjekti i mëposhtëm:

Emri:	**Intesa Sanpaolo S.p.A.**
Selia:	**Piazza San Carlo, 156 10121 Turin**
Përfaqësuesi ligjor:	**Carlo Messina, Administrator i Deleguar dhe DPE**
Nr. Regjistrimi në Regjistrin Tregtar të Torinos	**Regjistri Administrativ Ekonomik (REA) nr. 00799960158**
TVSH nr.:	**10810700152**
Nr. i telefonit (paneli):	(+39) 011 555 1
Identifikuesi i Objektit ISO (OID):	**1.3.6.1.4.1.20052**

Uebsajti i përgjithshëm (informacion):	**www.intesasanpaolo.com**
Uebsajti i Shërbimit të Certifikimit Dixhital:	**ca.intesasanpaolo.com**

2.2 Identifikimi i Manualit Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë

Manuali Operacional i Nënshkrimit Dixhital në Distancë identifikohet me kodin e dokumentit ISP-SCD-04-2022-06 (që përcaktohet edhe në faqen e titullit) dhe i referohet certifikatave me OID e meposhtme: 1.3.6.1.4.1.20052.1.3.1 dhe 1.3.6.1.4.1.20052.1.4.3.

Manuali Operacional i Nënshkrimit Dixhital në Distancë është botuar në faqen e internetit të Autoritetit të Certifikimit dhe për këtë arsye është e disponueshme në internet.

Versioni aktual Manualit Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë është i disponueshëm në formatin elektronik:

- Në faqen e internetit të Autoritetit të Certifikimit (https://ca.intesasanpaolo.com/);
- në faqen e internetit të AgID;
- në faqen e Internet Banking të Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale

Në rast mospërputhjesh, versioni që publikohet në faqen e internetit të AgID do të mbizotërojë në çdo kohë.

2.3 Personi përgjegjës për Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë

Veprimi	Zyra pergjegjese	Funksioni
Redaktimi	Zyra: Infrastruktura, Rrjeti, Zgjidhjet Info-fizike dhe te mbrojtjes se te dhenave	Sikuria Kibernetike dhe Menaxhimi i Vazhdimesise se Biznesit
Miratimi	Giorgio Cusmà Lorenzo	Pergjegjes: Siguria Kibernetike dhe Strategjia e Vahdimesise se Biznesit dhe Qeverisja e Grupit

3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Detyrimet e Autoritetit të Regjistrimit, Autoritetit te Certifikimit dhe Titullarit

3.1.1 Detyrimet e Autoritetit të Certifikimit dhe Autoritetit të Regjistrimit

Autoriteti i Certifikimit do të veprojë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Dekretin legjislativ [DLgs 82/2005], neni 32, duke miratuar të gjitha masat organizative dhe teknike për të parandaluar çdo dëmtim të palëve të treta.

Autoriteti i Certifikimit i cili, në përputhje me nenin 27 të Dekretit Legjislativ [DLgs 82/2005], lëshon certifikatat e kualifikuara për nënshkrim elektronik gjithashtu duhet:

- të identifikojë si duhet Aplikantin (dhe mbajtësin/titullarin nëse është i ndryshëm); ky aktivitet kryhet nga Autoriteti i Regjistrimit në përputhje me legjislacionin kombëtar;
- të informojë qartë dhe plotësisht aplikantët (dhe mbajtësin/titullarin nëse është i ndryshëm) mbi karakteristikat e certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik dhe kufizimet e përdorimit të tyre; ky aktivitet kryhet nga Autoriteti i Regjistrimit përpara nënshkrimit të Marrëveshjes për Ofrimin e kontratës së shërbimeve të certifikimit;
- të vazhdojë, në bazë të udhëzimeve të dhëna menjëherë nga Autoriteti i Regjistrimit, me revokimin në kohë të certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik dhe publikimin përkatës;
- të miratojë masa sigurie për përpunimin e të dhënave personale të Përdoruesit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi; ky detyrim do të përmbushet nga Autoriteti i Regjistrimit dhe Autoriteti i Certifikimit;
- të lëshojë certifikatat e kualifikuara për nënshkrim elektronik, siç përshkruhet në [DPCM], në përputhje me [Rregulloren GDPR], sikundër ndryshohet dhe plotësohet në vijim;
- të respektojë rregullat teknike të përcaktuara në Manual [DPCM] dhe në nenin 71 të Dekretit legjislativ 82/2005;
- të sigurohet që pajisja e sigurt për gjenerimin e nënshkrimeve të ketë karakteristikat dhe kërkesat e sigurisë të përcaktuara në nenin 35 të dekretit legjislativ [DLgs 82/2005] dhe nenin 11 të [DPCM];
- të ruajë regjistrimet, edhe në formë elektronike, të të gjitha informacioneve në lidhje me certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik për të paktën 20 (njëzet) vjet, në mënyrë që të jenë në gjendje të sigurojnë provë të certifikimit për çdo proces të mundshëm gjyqësor;
- të ruajë regjistrime, edhe në formë elektronike, të të gjitha dokumenteve të nënshkruara nga mbajtësi/titullari gjatë certifikatave të kualifikuara për procedurën e lëshimit të nënshkrimeve elektronike për të paktën 20 (njëzet); ky aktivitet kryhet nga Autoriteti i Regjistrimit;
- të mos eksportojë kodet privatë të Mbajtësve/Titullarëve nga HSM, nëse këto kode janë gjeneruar dhe janë përdorur;

- Autoriteti i Certifikimit dhe Autoriteti i Regjistrimit do të përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë dhe, Autoriteti i Regjistrimit do të informojë menjëherë përdoruesin për ndryshimet e aplikuara.

3.1.2 Detyrimet e Titullarit

Titullari/Mbajtësi duhet të sigurojë ruajtjen e të gjitha informacioneve që mundësojnë përdorimin e kodit privat dhe do të miratojë të gjitha masat teknike dhe organizative për të parandaluar ndonjë dëmtim të palëve të treta; titullari/mbajtësi duhet gjithashtu të përdorë personalisht të dhënat që mundësojnë krijimin e nënshkrimit dixhital (neni 8 (5) i [DPCM]).

Titullari/Mbajtësi do të respektojë [DPCM]; në veçanti, nga Titullari/Mbajtësi duhet:

- të kërkojë certifikatat e kualifikuara për nënshkrim elektronik, sipas procedurave të përcaktuara në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë (RDS);
- të mbrojë kodet private (kodin e gjeneruar nga çelësi i sigurisë TOKEN dhe sms fjalëkalim me një përdorim OTP) të nevojshme për të përdorur certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik;
- të kërkojë revokimin e certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik, sipas procedurave të përcaktuara në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë RDS;
- të njoftojë menjëherë Autoritetin e Regjistrimit për çdo ndryshim të informacionit që i është dhënë Autoritetit të Regjistrimit gjatë procedurës së regjistrimit (të dhënat personale, adresat, etj.);
- të mos përdor kodin privat për qëllime të ndryshme nga ato që janë përcaktuar në kufizimet e përdorimit të përcaktuara në certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik në Marrëveshjen e Përdorimit të Shërbimit Digital Banking dhe Marrëveshjen për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit;
- të sigurojë saktësinë, vërtetësinë dhe plotësinë e informacionit personit që bën identifikimin, për kërkesën e certifikatës;
- të përdorë certifikatën vetëm për metodat e përcaktuara në këtë Manual Operacional dhe në ligjet aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.1.3 Detyrimet e personit juridik (nëse ka)

Në rast se titullari/mbajtësi përdorur një certifikatë të kualifikuar për nënshkrimin elektronik në emër të Subjektit Juridik, i njëjti subjekt juridik do të jetë pjesë e detyrimeve dhe do të duhet të sigurojë autorizimin e duhur për Titullarin/Mbajtësin që të përdorë një certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik në emër të tij.

Subjekti juridik duhet të zbatojë [DPCM]; në veçanti, nga subjekti juridik duhet:

- të autorizojë kërkesën e Titullarit/Mbajtësit që të ketë një certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik, sipas procedurave të përcaktuara në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë;
- të kërkojë revokimin e certifikatës së kualifikuar për nënshkrimin elektronik, sipas procedurave të përcaktuara në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë;

- të njoftojë menjëherë Autoritetin e Regjistrimit për çdo ndryshim të informacionit që i është dhënë Autoritetit të Regjistrimit gjatë procedurës së regjistrimit (të dhënat personale të titullarit/mbajtësit, vdekja e titullarit/mbajtësit, humbja e aftësisë së biznesit të titullarit/mbajtësit, të dhënat e subjektit juridik, etj.);
- të përdorë certifikatën vetëm për metodat e përcaktuara në Manualin Operacional të Nënshkrimit Dixhital në Distancë dhe ligjet aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.1.4 Detyrimet e subjektit që duhet të verifikojë nënshkrimin

Subjektet përgjegjëse për të verifikuar nënshkrimin elektronik të gjeneruar nga kodet e certifikimit nga Intesa Sanpaolo, duhet të:

- verifikojnë periudhën e vlefshmërisë së certifikatës (në përputhje me rregulloren aktuale);
- kontrollojnë ne listën e certifikatave të revokuara të kualifikuara për nënshkrimin elektronik nëse certifikata është revokuar në momentin e nënshkrimit;
- sigurojnë që nënshkrimi elektronik i referohet një certifikate të kualifikuar të lëshuar nga një Autoritet Certifikimi i aprovuar më parë nga AgID në momentin e nënshkrimit;
- sigurojnë që tipologjia e kodeve "abonim" të gjeneruar (siç parashikon [DPCM], neni 5, pika 4, shkronja a) dhe kodi i përdorimit shtesë 11 të certifikatës (OID: 2.3.29.15) të ketë vetëm vlerën e refuzimit (bit 1 vendoset në 1) ;
- verifikojnë kufizimet e përdorimit të specifikuara në certifikatën e kualifikuar.

3.2 Kufizimi i përgjegjësisë dhe dëmshpërblimi

3.2.1 Kufizimi i përgjegjësisë

Intesa Sanpaolo nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë ndërprerje që rezulton nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi nga ana e Titullarit/mbajtësit, si dhe nga mosrespektimi i specifikave teknike / operacionale që parashikohen në Marrëveshjen e Përdorimit të Shërbimit Digital Banking nënshkruar nga dhe ndërmjet titullarit/mbajtësit dhe Bankës përkatëse ose në çdo dokumenti që referohet.

Intesa Sanpaolo nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet që rezultojnë nga çdo përdorim që tejkalon kufijtë e specifikuar në certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik dhe / ose në Marrëveshjen e Përdorimit të Shërbimit Digital banking dhe / ose Marrëveshjen për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit.

Kufizimet e përdorimit të specifikuara në certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik janë si më poshtë vijon:

Nenshkrimi Elektronik i Kualifikuar i Intesa Sanpaolo CA 2:

Perdorim i kufizuar per dokumentet ne lidhje me marredheniet e titullarit te certifikates me kompanite e Grupit Intesa Sanpaolo ose persona te tjere jashte Grupit te cilet ofrojne sherbimet e tyre per sistemet elektronike te kompanive te Grupit "

Nenshkrimi i Kualifikuar CA i Intesa Sanpaolo S.p.A.:

Perdorim i kufizuar per dokumentet ne lidhje me marredheniet e titullarit te certifikates me kompanite e Grupit Intesa Sanpaolo ose persona te tjere jashte Grupit te cilet ofrojne sherbimet e tyre per sistemet elektronike te kompanive te Grupit "

Gjithashtu, përdorimi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik do të kufizohet në domenin e specifikuar në Marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve të Certifikimit.

Kufizime të tjera specifike për një produkt të vetëm ose një ligj kombëtar do të trajtohen në Manualet Operacionale që i dedikohet një produkti specifik.

3.2.2 Dëmshpërblimi

Sikundër parashikohet në mënyrë të detajuar në nenin 3.2.1 më lart Intesa Sanpaolo nuk do të jetë përgjegjës për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i papërshtatshëm i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik.

Megjithatë, në bazë të nenit 15 (1) i) të [DPCM], Intesa Sanpaolo ka përcaktuar një sigurim të caktuar specifik për të mbuluar rreziqet përkatëse dhe dëmet që rezultojnë nga ose në lidhje me lëshimin e certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik.

3.3 Orari i disponueshmërisë

Shërbimet që ofrohen nga Autoriteti i Certifikimit (lëshimi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik dhe përdorimi i nënshkrimit elektronik) janë në dispozicion përmes kanaleve direkte (në internet dhe celular) dhe nëpërmjet degës. Revokimi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik ofrohet edhe nëpërmjet degës.

4. ASPEKTET OPERACIONALE

4.1 Përmbajtja e certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik

Përmbajtja e certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik të lëshuar nga Intesa Sanpaolo është në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 28 të dekretit legjislativ [Dlgs 82/2005] për specifikimin ITU-T X.509 v3 (ISO/IEC 9594-8:2005) dhe me Rregulloren Europiane ETSI EN 319 411 ed ETSI EN 319 412 (nëse zbatohet).

Duke iu referuar Vendimit të AgID nr 121/2019, në të parashikohet se certifikatat e kualifikuara lëshohen nga Intesa Sanpaolo sipas rekomandimeve të cilat janë referuar në kapitullin 4 të dispozitave të sipërpërmendur, me përjashtim të fushave të mëposhtme:

- Subjekti DN: numri i serisë (OID 2.5.4.5): një kod unik që lidhet me titullarin përdoret nëpërmjet një kushti emërtimi të ndryshme nga ai që përcaktohet në rekomandimet e referuara në kapitullin 4 të vendimit nr. 121/2019 të AgID
- Subjekti DN: emri i organizatës (OID 2.5.4.10): nëse pronari është një klient I thjeshtë i organizatës, fusha e emrit të organizatës ende përdoret, por përforcohet me fjalën “jo prezent”.

Duke qenë se të gjitha rekomandimet e vendimit nr. 121/2019 nuk zbatohen, certifikatat që janë lëshuar nga Intesa Sanpaolo nuk përmbajnë kodimin në fushën e Politikave të Certifikatës (OID 2.5.29.32) në një element të identifikuesit të politikës me vlerën e AgID (OID 1.3.76.16.6). Certifikatat e kualifikuara për nënshkrimin elektronik nuk do të publikohen në regjistrat që janë të disponueshëm për publikun.
Periudha e vlefshmërisë për secilën certifikatë të kualifikuar është 3 (tre) vjet.

Nënshkrimi Dixhital në distancë autorizon mbajtësin/titullarin dhe subjektin juridik (nëse aplikohet) të lidhin një kontratë me Bankën. Nënshkrimi dixhital në distancë mund të përdoret nëpërmjet të gjitha kanaleve (përfshirë kanalet dixhitale: dega dixhitale, on-line banking dhe blerja dixhitale) sipas ofertës dhe mundësive në kohë të Bankës Një certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin elektronik duhet t'i lejojë mbajtësit/titullarit përdorimin e nënshkrimit dixhital në distancë.

4.2 Rregullat për organizimin e punonjësve

Punonjësit përgjegjës për ofrimin dhe kontrollin e shërbimit të certifikimit është i organizuar në bazë të kuptimit të [DPCM 2013] që do të thotë që, ndër të tjera, rolet e përgjegjësisë janë parashikuar sikundër përcaktohet në nenin 38 të [DPCM].

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, punonjësi që ka role përgjegjësie mund të përfitojë nga punonjësit dhe operatorët, që gjithashtu i përkasin Bankave.

Lidhur me Manualin Operacional RDS, operatorët kryejnë shërbimin e certifikimit (këtu ka kuptimin e regjistrimit ose identifikimit të mbajtësit/titullarit) në degët e Bankave, jashtë qendrës së përpunimit të të dhënave të Intesa Sanpaolo; shkëmbimi i informacionit ndërmjet operatorëve dhe Intesa Sanpaolo bëhet përmes kanaleve të sigurta të komunikimit.
Aktiviteti i regjistrimit kryhet nga Bankat në bazë të një kontrate specifike që lidhet nga dhe ndërmjet Bankës përkatëse dhe Intesa Sanpaolo.
Operatorët e Bankave kryejnë veprimtarinë e regjistrimit në përputhje me procedurat e dakordësuara midis Bankave dhe Intesa Sanpaolo dhe kryhen përmes një procedure në përputhshmëri të plotë.

4.3 Procedura e gjenerimit të kodit

Çdo lloj kodi i listuar në nenin 5 të [DPCM] gjenerohet, ruhet dhe përdoret brenda pajisjeve të sigurta, të cilat janë në përputhje me kërkesat e sigurisë të përcaktuara dhe parashikuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Kodet kanë karakteristikat e përcaktuara në [DPCM].

4.3.1 Certifikimi i procedurës së gjenerimit të kodit[1]

Gjenerimi i kodeve të certifikimit kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, dhe veçanërisht:

- kodet e certifikimit gjenerohen nga punonjësit e caktuar shprehimisht nga Autoriteti i Certifikimit;
- një certifikatë specifike e kualifikuar për nënshkrimin elektronik gjenerohet për secilën palë të kodeve të certifikimit, sikundër përcaktohet në paragrafin 4.1, nënshkruar me kodin privat përkatës të çiftit, i cili i dërgohet AgID-it në përputhje me procedurat e dakordësuara më parë midis Autoritetit të Certifikimit dhe AgID.

4.3.2 Vula datare/orës procedura e gjenerimit të kodit

Në lidhje me shërbimin e vulës datare/orës për shërbimet e nënshkrimit dixhital, që i sigurohen Bankës, Intesa Sanpaolo përdor një autoritet certifikimi që plotëson kërkesat e nevojshme për të ofruar shërbime në vendin ku ndodhet Banka përkatëse.

4.4 Procedura e identifikimit dhe regjistrimit të përdoruesit

Lëshimi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrimin elektronik është e vlefshme vetëm për ata që janë kualifikuar si Përdorues, përkatësisht personi që nënshkruan Marrëveshjen për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit me Bankën.

Certifikatat e Kualifikuara të Përdoruesit individual për nënshkrimin elektronik përmbajnë informacion dhe të dhëna personale të mbajtësit/titullarit. Certifikatat e kualifikuara të Subjektit Ligjor të Përdoruesit përfundimtar për nënshkrimin elektronik mund të përmbajnë të dhëna personale për mbajtësin, si dhe informacione rreth subjektit juridik.

Procedurat e identifikimit dhe regjistrimit të përdoruesit kryhen nga Banka përkatëse në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në rregulloren për parandalimin e pastrimit të parave, të cilat do të respektohen në kohën e lidhjes së marrëdhënieve kontraktuale me këtë të fundit.
Për Subjektet Juridike, rregullorja për parandalimin e pastrimit të parave është e zbatueshme për Subjektin Juridik dhe jo për Mbajtësin/Titullarin. Në këtë rast, identifikimi i mbajtësit kryhet personalisht.

Identifikimi i mbajtësit/titullarit dhe / ose aplikantit do të bëhet personalisht (i) me prezencë fizike të Përdoruesit në mjediset e Bankës, ose (ii) në distancë, me anë të përdorimit të metodave të identifikimit që njihen për sigurimin dhe ofrimin e një sigurie ekuivalente për sa i përket besueshmërisë. Këto aktivitete kryhen përmes një procedure në përputhje me aspektet për parandalimin e pastrimit të parave ose një procedurë me prezencë fizike, e cila merr gjithashtu dhe në konsideratë nenin 24 1. (d) të Rregullores së Eidas.

4.4.1 Identifikimi dhe regjistrimi i përdoruesit

Përdoruesi identifikohet përmes procedurave të përcaktuara paraprakisht që ndryshojnë në varësi të kanalit të bankës dixhitale.
Identifikimi i Përdoruesit kryhet ose përmes prezencës fizike ose në distancë. Në veçanti:

[1] Kodet përdoren nga Autoriteti i Certifikimit për të lëshuar certifikata të kualifikuara për nënshkrime elektronike, sipas kërkesës së Titullarit

- Gjatë identifikimit personalisht në Degën Dixhitale, numri celular që jepet nga Përdoruesi certifikohet duke dërguar fjalëkalimin me një përdorim OTP përmes një mesazhi telefonik sms dhe duke i kërkuar përdoruesit që ta vendosë atë. Përdoruesi gjithashtu do të identifikohet duke skanuar kartën e tij të debitit në lexuesin e kartave;
- Gjatë identifikimit online në Shërbimet Bankare Dixhitale në distancë, Përdoruesi vërteton në celular / Përgjegjës me ID e regjistrimit dhe fjalëkalimin me një përdorim OTP të gjeneruar duke future kodin PIN në çelësin e tij të sigurisë TOKEN të tij / saj në përputhje me Shërbimin Bankar Dixhital dhe fjalëkalimit me një përdorim OTP shtesë që Përdoruesi merr përmes mesazhit sms në numrin e tij të celularit të certifikuar;
- Gjatë identifikimit nëpërmjet videos për Blerjen Dixhitale, certifikohet numri celular që jep përdoruesi duke dërguar fjalëkalimin me një përdorim OTP përmes mesazhit telefonik sms dhe duke i kërkuar përdoruesit ta vendos atë.

Të gjitha procedurat e identifikimit kryhen duke ndjekur rregulloren lokale të Bankës dhe përmes një procedure në përputhje me aspektet për parandalimin e pastrimit të parave ose një procedurës që kryhet me prani fizike.
Identifikimi i Përdoruesit kryhet nga Banka përkatëse përpara regjistrimit të certifikatës së kualifikuar për nënshkrimit elektronik.
Pas identifikimit me sukses, Përdoruesi është në gjendje të vazhdojë me aktivizimin e shërbimit të nënshkrimit dixhital në distancë dhe me nënshkrimin e kontratës përkatëse.

4.4.2 Aktivizimi i individëve të shërbimit për Nënshkrimin Dixhital në Distancë dhe nënshkrimi i kontratës përkatëse.

Për të aktivizuar një nënshkrim dixhital në distancë dhe për të nënshkruar Marrëveshjen për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit, Aplikanti duhet të përmbushë hapat e mëposhtëm procedurale në kanale të ndryshme

Shërbimet Bankare Dixhitale në Distancë:

- akseson Shërbimin Bankar Dixhital duke përdorur procedurat e vërtetimit dhe autentifikimit të përcaktuara nga Banka përkatëse;
- sipas kërkesës, pranon rregullat që rregullojnë Marrëveshjen për Ofrimin e shërbimeve të Certifikimit;
- sipas kërkesës, kontrollon dhe konfirmon saktësinë e të dhënave personale të tij / saj me qëllim për të aktivizuar certifikatën e kualifikuar për nënshkrimin elektronik;
- kërkesa për regjistrimin e certifikatës;
